



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA KORÇË
KËSHILLI BASHKIAK**

ALEANCA E GRAVE KËSHILLTARE

RAPORT

**MBI PROJEKTIN
QËNDRA DITORE PËR FËMIJË-FUQIZIMI I FËMIJVE ROMË DHE EGJIPTIANË**

Të nderuar Këshilltarë!

Aleanca e Grave Këshilltare ,

Gjatë hartimit të planit e aktiviteteve për vitin 2025 ka synuar përcaktimin e një kornize orientuese mbi punën dhe aktivitetin e Këshillit të Bashkisë Korçë, por dhe si një iniciativë e Aleancës së Grave Këshilltare, duke pasur parasysh fuqizimin, ruajtjen e autonomisë së këshillit, si edhe sigurimin e ushtrimit të funksionit legjislativ si organ përfaqësues, vendimarrës, mbikëqyrës e monitorues.

Në zbatim të rolit mbikëqyrës dhe monitores të këshillit, Aleanca e Grave Këshilltare Korçë, për muajin qershor ju informojmë:

MBI PROJEKTIN QËNDRA DITORE PËR FËMIJË-FUQIZIMI I FËMIJVE ROMË DHE EGJIPTIANË

Bashkia Korçë në kuadër të një qyteti social dhe gjithëpërfshirës prej shumë vitesh ka ngritur tre qendra për fëmijët e komunitetit rom dhe egjiptian të shpërndara në zona të ndryshme të qytetit. Këto qendra kanë si qëllim të përmirësojnë mirëqenien e komunitetit Rom dhe atij Egjiptian përmes integritit social dhe reduktimit të varfërisë si dhe rritjen e aftësive konjitive dhe psiko-sociale të fëmijëve.

Bashkia Korçë në bashkëpunim me Fondaconin Misioni Emanuel firmosin çdo vit një marrëveshje bashkëpunimi për menaxhimin e këtyre qendrave.
Bashkia Korçë bën pagesën e qerasë, ujit dhe dritave.

Në këto qendra marrin shërbim 100 fëmijë të komunitetit Rom dhe Egjiptian.
Në këto qendra ofrohet një vakt i ngrohtë ushqimor, fëmijët asistohen nga mësueset për realizimin e detyrave të shkollës, realizohen aktivitete edukuese, argëtuese për fëmijët dhe prindërit e tyre.

Aktivitetet që ofrohen në këto qendra janë:

-Monitorim në kryerjen e detyrave dhe mësimëve të shkollës nën kujdesin e dy mësueseve profesionale.

-Përfshirja e fëmijve-Sesioni i prindërimit.

-Ofrimi i një vakti të ngrohtë dhe të shëndetshëm ushqimor.

-Përkrahje psikologjike , morale dhe shpirtërore nën kujdesin e një punonjëseje sociale.

-Festime ditëlindjesh.

-Ekskursionë.

-Kampe verore.

-Sigurimi i medikamenteve dhe kujdesit mjekësor në përputhje me recetat e dhëna nga mjeku.

-Trajnime për çështjet e higjienës dhe ushqimit të shëndetshëm.

-Mbledhje me Komitetin i Prindërve të përbërë nga 6 anëtarë të cilët do të delegojnë mendimet dhe idetë e pjesës tjetër të prindërve.

Fëmijët të cilët marrin shërbim pranë qendrave ditore për fëmijë, një pjesë e konsiderueshme e këtyre fëmijve përfitojnë bursa sipas vkm 666 datë 10.10.2029 të cilët i përkasin komunitetit rom dhe egjiptian, e cila ka si qëllim uljen e nivelit të braktisjes shkollore.

Aktivitetet tek qendrat ditore të fëmijëve

Janar-Prill 2025

Nr.	Përshkrimi i aktivitetit
1.	Fëmijëve u ofrohet një vakt i shëndetshëm (dreka) nga e hëna në të premte.
2.	Mbahen takime të rregullta midis mësuesve të qendrave dhe atyre të shkollave (si dhe psikologëve shkollore) që ndjekin fëmijët, për të diskutuar mbi performancën ose çështjet e tyre.
3.	Fëmijëve u ofrohen shërbime pas orarit të shkollës.
4.	Fëmijët mësojnë aftësi jetësore përmes kurrikulës Aflatoun.
5.	Fëmijët marrin pjesë në kampe verore.
6.	Fëmijët mësojnë për të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre në shkollë dhe në qendra.
7.	Aktivitete ndërbreznore (2G/3G) – fëmijët mësojnë nga gjyshet/nënat për punime dore, gatim, rrjete sociale, etj.
8.	Fëmijët organizojnë së bashku me mësuesit dhe festojnë ngjarje/ festa kombëtare/ ditëlindje.
9.	Psikologët e shkollave/qendrave zhvillojnë takime të vazhdueshme me fëmijët për kuptim, këshillim dhe parandalim.
10.	Mbështetje shëndetësore për fëmijët.
11.	Fëmijët mësojnë rreth traumës dhe angazhohen në aktivitete/lojëra të ndryshme për të mësuar si të përballen me të.

12.	Prindërit të cilët nuk janë mjaftueshëm të vetëdijshëm për potencialin dhe sfidat e tyre kalojnë në një proces mentorimi, udhëzimi dhe trajnimi.
13.	Takime me komitetet e prindërve për të diskutuar çështje të rëndësishme që lidhen me projektin.
14.	Trajnime prindërimi organizohen në çdo qendër.
15.	Organizohen takime me prindërit mbi planifikimin familjar dhe kujdesin shëndetësor, nga institucionet publike shëndetësore.
16.	Mësuesit e qendrave organizojnë sesione mbi mbrojtjen e fëmijëve me fëmijët dhe prindërit, veçmas.
17.	Organizohen trajnime mbi ABCD me palët e interesuara të projektit, mësues, liderë komuniteti dhe institucione lokale.

Ju Faleminderit!

Kryetare

Ana VERUSHI